



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 1499 prot.

Ballsh, më 03/04 2024

VENDIM

Nr. 20 /datë: 28/03 /2024

PËR
MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË SHPENZIMEVE TË PROGRAMIT
BUXHETOR AFATMESEM 2025-2027

Këshilli Bashkiak Mallakastër në mbledhjen e datës 28.03.2024 pasi analizoi relacionin paraqitur Per miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027' Mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Reublikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr.68 datë 27.04.2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore", ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", si dhe në udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.3 datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027",:

VENDOSI:

1. Të miratoj Tavanet përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, për çdo program sipas tabelës bashkalidhur .
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Bashkia Mallakastër
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes

KRYETAR

NEXHMI SULAJ

